



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Tiranë, më 12.04.2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “ALBDESIGN - PSP” sh.p.k me NIPT: L51819005Q,
me adresë: Rruga “Çerçiz Topulli”, Nr.17, Ndërtesë Private, Lagjja Mëzezë, Kashar, Tiranë.
Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozime.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-86440-02-09-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i Printimit të Njoftim Detyrimeve për vitin 2021”,
kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 4 ditë nga kërkesa e Autoritetit
Kontraktor për printimin e Njoftim Detyrimeve.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike datë 15.02.2021, Buletini Nr. 21.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “Adel CO” sh.p.k, NIPTI: L22117021M
Vlera: 3.165.521 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH.
2. Shoqëria “ALBDESIGN - PSP” sh.p.k, NIPTI: L51819005Q
Vlera: 6.597.964 (gjashtë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
3. Shoqëria “INPRESS” sh.p.k, NIPTI: L52122014L
Vlera: 5.695.680 (pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “Adel CO” sh.p.k,

NIPTI: L22117021M

Vlera: 3.165.521 (tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH.

2. Shoqëria “INPRESS” sh.p.k,

NIPTI: L52122014L

Vlera: 5.695.680 (pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik pjesëmarrës “ADEL CO” sh.p.k, nuk ka plotësuar kërkesat për specifikimet teknike, sipas përcaktimeve në Shtojcën 8 të DST-ve, pasi në mostrat e paraqitura zarfi është pa Logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Gjithashtu ky operator ekonomik nuk ka plotësuar Kriteret e veçanta të kualifikimit, Pika 2.3 pasi nuk ka paraqitur dokumenta që vërtetojnë kryerjen e *shërbimeve me natyrë të ngjashme në një vlerë të paktën prej 40% të fondit limit dhe konkretisht punime që lidhen me procesin e zarfimit.*

Operatori ekonomik pjesëmarrës “INPRESS” sh.p.k, nuk ka përmbushur Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3 pasi, në lidhje me përvoja të sukseshme në kryerjen e shërbimeve me natyrë të ngjashme në nivel të paktën 40% të fondit limit (proçesi i zarfimit) që prokurohet.

Operatori ekonomik “INPRESS” sh.p.k, nuk përmbush Kriteret teknike të kualifikimit pasi, në lidhje me çertifikatat ISO, në asnjë prej çertifikateve të paraqitura nga subjekti nuk përfshihen fusha të njëjta me objektin e prokurimit sikurse është kërkuar në DST: *“Çertifikatat duhet të jenë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen”*

Në lidhje me mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “INPRESS” sh.p.k konkludojmë se ato nuk janë konform kërkesave në specifikimet teknike pasi zarfet e paraqitur janë të tipit me shirit ngjites manual dhe të tipit me ngjites i cili kryen funksionin nën efektin e lagështirës dhe jo të llojit sikurse e kërkon makineria e zarfimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ALBDESIGN - PSP” sh.p.k, me adresë: *Rruga “Çerçiz Topulli”, Nr.17, Ndërtesë Private, Lagjja Mëzezë, Kashar, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6.597.964 (*gjashtë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV)*, pranë *Bashkia Tiranë*, adresa: *Rruga e Kavajës, ish Uzina Mekanike, Tiranë*. Tel/Fax 04 2 419 70, Personi i kontaktit: alma.ballcaj@tirana.al / 069 48 62 827, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.03.2021

Ankesa: Ka

- Lidhur me Vendimin e klasifikimit: Ankimi i shoqërisë "INPRESS" sh.p.k, datë 23.03.2021, ka marrë përgjigje më datë 26.03.2021, nga AK dhe Vendimi i K.P.P-së me Nr. 157/2021, datë 09.04.2021.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arli Naska